



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË  
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datë **10.09.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Marrjen në pyetje dhe verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit personal *“Arrest në shtëpi”*, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj personave nën hetim **Rexhe Byberi** dhe **Abedin Kernaja**, të dyshuar për kryerjen e veprës penale *“Shpërdorimi i detyrës”*, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 248 e 25 të Kodit Penal”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Etleva Deda, bazuar në nenet 228, 229, 230, 232, 237, 244, 246 e 248 të K.Pr.Penale, me vendimin **Nr. 116, datë 12.09.2024**, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues *“Arrest në shtëpi”*, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, e caktuar me Vendimin nr. 112, datë 06.09.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj personit nën hetim **Rexhe BYBERI**, i dyshuar për kryerjen e veprës penale *“Shpërdorimi i detyrës”*, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 248 e 25 të Kodit Penal.
3. Urdhërohet personi nën hetim Rexhe Byberi të mos largohet nga banesa e tij, me adresë: \*\*\*\*.
4. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues *“Arrest në shtëpi”*, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, e caktuar me Vendimin nr. 112, datë 06.09.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj personit nën hetim **Abedin KERRNAJA**, i dyshuar për kryerjen e veprës penale *“Shpërdorimi i detyrës”*, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 248 e 25 të Kodit Penal.
5. Urdhërohet personi nën hetim Abedin Kernaja të mos largohet nga banesa e tij, me adresë:\*\*\*\*.
6. Urdhërohet Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për ekzekutimin e këtij vendimi.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, brënda afatit ligjor.

**Tiranë, më datë 12.09.2024**

**Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**